




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration


Për :	Xhafer Tahiri , Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Nasuf Aliu , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević , Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini , U.d. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 04/04/2019
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	020-379
Lloji i aktit:	Vendim	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 99/19 për shfuqizimin e pjesërishtëm të vendimit 01 Nr. 22/19 të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i datës 31.01.2019
I miratuar më datë: 28.03.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Za :	Xhafer Tahiri , gradonačelnik Opštine Vučitrn Nasuf Aliu , predsedavajući Skupštine opštine
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Ivan Todosijević , ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj , generalna sekretarka MALS-a
Od:	Venera Çerkini , v.d rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i i monitorisanje opština, MALS
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Vučitrn
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmantranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 99/19 za delimično ukidanje rešenja 01 Br. 22/19 Skupštine opštine Vučitrn od 31.01.2019
Usvojena dana, 28.03.2019. godine
Predložana za razmatranje u MALS-u dana, 04.04.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2019, mori këtë:

VENDIM



PËR SHFUQIZIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË ME 01NR.22/19 I DATËS 31.1.2019

1. Me këtë vendim shfuqizohet pika 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01 Nr.22/19 i datës 31.1.2019, që ka të bëjë me parcelën kadastrale P-7020216-02356-1 në sipërfaqe prej 1058 m².
2. Me vendim paraprak me Nr.22/19 ishte dhënë në shfrytëzim prona e cekur në pikën 1 të këtij vendimi në periudhë afatgjate prej 99 viteve, tani kuvendi vendos që kjo pronë të mbetet në pronësi komunale për interes të përgjithshëm.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6, 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, nenit 11,12 të Rregullores QRK NR.23/2013 për Çaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2019, mori këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

1 Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrisë evidentuar në ngastrën kadastrale P-70202016-00001-1, P-70202016-02356-1 dhe P-70202016-00129-0 Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrisë.

1.1 Pjesë nga ngastra kadastrale P-7020216-00001-1 në sipërfaqe prej 9100m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 14732m², jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik për personat fizikë dhe juridikë, për rregullimin e hapësirës sipas Vendimit 58/2016 të dt.20.12.2016 të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumeteve.

1.2 Ngastra kadastrale P-7020216-02356-1 në sipërfaqe prej 1058 m², jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik për personat fizikë dhe juridikë për ndërtim të lartë. Komuna do ta ruajë interesin e saj publik përmes kushteve që do t'i përcaktojë në rastin e zhvillimit të procedurave të konkursit publik, kurse pjesën tjetër investitori.


1.3 Ngastra kadastrale P-7020216-00129-0 në sipërfaqe prej 473 m² me objekt, jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik për personat fizikë dhe juridikë.


2. Obligohet Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale që të zhvillojë procedurat për shpalljen e konkursit publik, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të konkursit publik.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr.01Nr.502/09 të dt.30.07.2009 për dhënie në shfrytëzim me koncesion të pronës komunale, pjesë e parcelës nr.1-1, Zona Kadastrale Vushtri.

4. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: Certifikatat e pronës, kopjet e planit dhe vendimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Nasuf Aliu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Venera Çerkini, U.d. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
Lloji i aktit:	Vendim

I/e nderuar Kryetar,

I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 22/19 paraprak për dhënien në shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës

I miratuar më datë: 31.01.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.02.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDIT DHE PLANIFIKIMIT BAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

18127

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-02356-1


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	18-26/19
Data dhe koha e testimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	08.01.2019 - 10:40
Komuna / Opština / Municipality:	Vushtri / Vučitrin / Vushtri
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	Vushtri / Vučitrin / Vushtri

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202016-02356-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena / Inovana / Socially owned Land	Urban	1058		06.07.2015	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Podjedinosti adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
JNA-LIKE / JNA-LIKE / JNA-LIKE		JNA-LIKE	06.07.2015	



A.2 LLOJI I SHRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type of Use	Shrytëzimi aktual i parcelës Trenutho koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kualitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Pacstina (m²) Area
1	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/ construction land	Char/Dvo.šije Back Yard		500
2	Bujëqesore Poljoprivredna/Agriculture	Arë/Niv. Arable	Arë E Klases I Niv. 3 Klase 3rd Class Arable Land	336
3	Tokë Ndërtimore, Građevinsko zemljište/ construction land	Shënpj. Ndërtimsh. Kucor Zgjedra/House-Building		222

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personali Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postarski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesë e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Pronësi individualë (Një Pronarë)/ Individualno Vlasništvo (1 Vll.) / single owner	P SH.KOMUNA E VUSHTRRISE	KCID0201037	VUSHTRRI / VUSHTRRI		2	1/1		07.07.2015

